

Ndikimi në ekosistem: I rrezikshëm për insektet e dobishme. H410: Shumë toksik për jetën ujore me efekte afatgjata. SP1: Mos e ndotni ujin me produktin ose enën e tij. Mos i pastroni paisjet e aplikimit në afërsi të ujërave sipërfaqësore. Shmangni ndotjen nëpërmjet kanalizimeve nga fermat dhe rugët. Në rast të përdorimit të dozës deri 2.5 lit/ha, duhet të respektohet një brez sigurie prej 5 m për kulturat që nuk janë objekt i trajtimit. Kur doza e përdorimit është më e lartë se 2.5 lit/ha, brezi i sigurisë shkon deri në 10 m.

Magazinimi: Magazinohet në vende të ajrosura, të freskëta dhe pa lagështirë në temperaturë 0-40° C.

Masat parambrojtëse:

• P102: Mbajeni në vende të sigurta dhe të pa arritëshme nga fëmijët. • Ruajeni në vende të të thata dhe të freskëta, larg ushqimeve dhe pijeve për njerëzit si dhe ushqimeve për blegtorinë. • P261: Evitoni kontaktin e produktit me gojën, lëkurën, sytë dhe thithjen e tretësirës spërkatëse nëpërmjet frymëmarrjes. • Gjatë përdorimit të tij mos ha e mos pi ujë dhe duhan. • P280: Gjatë punës përdor paisje mbrojtëse: kominoshe, doreza, maska, syze. • EUH401: Për të shmangur rreziqet për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, ndiqni udhëzimet për përdorim. • Në përfundim të punës, lani duart dhe pjeset e ekspozuara të trupit, paisjet mbrojtëse dhe mjetet spërkatëse. • P501: Asgjësoni përmbajtjen/enën në përputhje me rregulloret kombëtare në fuqi.

Udhëzime për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun:

• H335: Mund të shkaktojë iritim respirator. Në rast thithje: çvendoseni të aksidentuarin në ajër të freskët dhe vendoseni në një pozicion që lehtëson frymëmarrjen. Kërkoni ndihmë mjekësore. • H304: Mund të jetë fatale nëse gëlltitet dhe hyn në rrugët e frymëmarrjes. Në rast gëlltitje: çvendoseni të aksidentuarin në ajër të freskët dhe vendoseni në një pozicion që lehtëson frymëmarrjen. Kërkoni ndihmë mjekësore. P331: Mos provokoni të vjella. • H315: Shkakton iritim të lëkurës. EUH066: Ekspozimi i përsëritur mund të shkaktojë tharjen ose plasaritjen e lëkurës. Në rast kontakti me lëkurën: çvendoseni të aksidentuarin nga burimi i kontaminimit. Hiqni veshjet e ndotura dhe lani lëkurën tërësisht me ujë. Kërkoni këshilla mjekësore nëse acarimi vazhdon pas larjes. • H336: Mund të shkaktojë përgjumje ose marrje mendsh. • H319: Shkakton acarime të rënda të syve. P305+P351+P338: Në rast se solucionit bie në sy: shplajni me kujdes për disa minuta. Hiqni lentet e kontaktit dhe vazhdoni shpëlarjen. • Nuk ka antidot specifik dhe terapia është simptomatike.

Data e prodhimit:

Data e skadimit: printuar ne ambalazh

1 Lit.

LEOPARD 5 EC

PRODUKT PËR MBROJTJEN E BIMËVE

“Lexo fletudhëzuesin para përdorimit”

Lënda vepruese: 5 % Quizalofop-P-ethyl

Formulimi: Koncentrat i emulsionueshëm (EC)

Nr. i regjistrimit: 706, dt. 08/05/2019



HERBICID SELEKTIV SISTEMIK, I PAS MBIRJES. THITHET NGA GJETHET E BARËRAVE TË KËQIA TË SAPO MBIRA. VEPRON NGADALË: NEVOJITEN 7-15 DITË, NË VARTËSI TË STINËS, PËR TË DHËNË EFEKTIN HERBICID.



MELDI Sh.p.k.

Distributor:
MELDI Sh.p.k.
Tirane - Shqipëri



Prodhues: ADAMA Agan Ltd
Aplikant: ADAMA Agriculture BV.

Përdorimi: Kontrollon barërat e këqia graminore: - **një vjeçare:** *Alopecurus myosuroides, Lolium spp., Echinochloa crus-galli, Setaria spp., Digitaria sanguinalis, Avena spp., Phalaris spp.;* - **shumë vjeçare:** *Agropyron repens, Elimus repens, Cynodon dactylon, Sorghum halepense.*

Për kontrollin e barërave të këqia një vjeçare përdoret me 1-2.5 lit/ha, ndërsa për kontrollin e barërave graminore shumë vjeçare përdoret me 2-2.5 lit/ha. Sasia e ujit: 300-400 lit/ha. Doza më e ulët përdoret në fazat e para të zhvillimit të barërave të këqia, ndërsa në fazat e mëvonshme përdoret doza më e lartë e sipërpërmendur. **Në patate:** Pas daljes së gjetheve të para, kur gjatësia e tyre arrin deri 4 cm dhe vazhdon deri sapo fillon bashkimi i bimëve me njëra-tjetrën mes rreshtave. **Në bizele:** Nga shpaloja e çiftit të parë të gjetheve të vërteta deri në fillim të lulëzimit. **Në fasule:** nga zhvillimi i gjetheve të para deri në fillim të lidhjes së bishtajave. **Në spinaq:** nga zhvillimi i gjetheve të para deri në forcimin e kërcejve. **Në qepë e hudher:** 1-2.5 lit/ha. Nga fiksimi në tokë i rrënjëve kur gjethet e dyta arrin 3-4 cm dhe vazhdon deri në përfundimin e ritjes gjatësore të gjetheve dhe fillimi i formimit të bulbit, mund të vazhdojnë trajtimet në rast infeksionesh deri në fazën kur bulbi arrin 30% të zhvillimit. **Në lakëër, lulelakër, patëllxhan, brokoli:** përdoret deri në fazën e paralulëzimit. **Në domate:** Nga faza e 2-3 javë pas trapiantimit deri para lidhjes së frutave. **Në duhan:** dy javë pas trapiantimit deri në fazën BBCH 40. **Në pemët frutore berthamore:** pas mbirje së barërave, deri në fazën para lidhjes së frutave, me 2-3.5 lit/ha. **Në vreshta:** përdoret deri në fillim të mbylljes së veshulit. **Në pemët frutore farore:** deri në ritjen mesatare të kokrrës ose pa filluar ngjyrosja. **Përdoret dhe në panxhar sheqeri, kolzë, luledielli, sojë, jonxhë.** Për kontrollin e *Sorghum halepense* (me rizoza), mund të ndërhyhet me: - trajtim në dy faza, 1.5 lit preparat/ha, kur barërat e këqia janë në 20-30 cm lartësi, pasuar me trajtim të dytë me 2 lit/ha; - trajtim i vetëm me 2.5 lit/ha, kur barërat e këqia janë në fazën e ritjes. Për kontrollin e njëkohshëm edhe të barërave të këqia gjethe gjera mund të përzihet me herbicide të tjera, por duke bërë prova para përdorimit të përzierjes.

Vërejtje për përdorimin: Nuk kontrollon barërat e këqia gjethe ngushta jo graminore si: *Qiperin, Imperata cilindrica* dhe flokëzën. Kur mbirja e barërave të këqia zgjat për shumë kohë, është më mirë të bëhen dy spërkatje (duke përdorur në sejcilën prej tyre gjysmën e dozës së rekomanduar në intervale një muaj). Mos mbillni të lashta ose misër në parcelat e trajtuara pa kaluar të paktën dy muaj nga spërkatja. Nuk rekomandohet përdorimi i këtij produkti në toka shumë ranore. Mos spërkatni në ditë me erë. Spërkatni me presion më të ulët se 3 atm dhe përdorni sprucatorë të tipit fshesë.

Fitotoksiciteti: Është fitotoksik për të lashtat.

Karenca: 1 javë para vjeljes për agrumet; 6 javë për lule diellin; 10 javë për pambukun; 1 muaj për pemët frutore, ullinjë dhe vreshtin; 8 javë për patatën, panxharin, duhanin, fasulen, sojën.